



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 30/2021

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat [REDACTED], si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDACTED] pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, palës ankuese z. Njazi Haliti dhe përmbaruesit privat, [REDACTED], dhe pas seancës këshillimore, me datën 02.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-30/2021, datë 04.10.2021, si dhe ankesa e palës ankuese [REDACTED] dt 02.09.2021, si të pabazuara.

A R S Y E T I M

Me datën 02.09.2021, pala ankuese [REDACTED] nga Mitrovica ka paraqitur një ankesë në Ministrinë e Drejtësisë- Departamentin për Profesione të Lira, Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat [REDACTED], për shkelje disiplinore. Pala ankuese thekson që përmbaruesi privat [REDACTED] nuk ka ndërmarr veprime përmbarimore për realizimin e të drejtës së palës ankuese për pagesën e vlerës prej 2,500.00 Euro në emër të kompensimit të dëmit nga pala debitore [REDACTED]. Sipas palës ankuese, përmbaruesi privat [REDACTED] nga pala ankuese ka marr shumë prej 100 Euro dhe pas marrjes së kësaj shume ka refuzuar të kontaktojë me palën ankuese.

Me dt 04.09.2021, Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ka kërkuar nga pala ankuese plotësimin e ankesës në përputhje

me nenin 5 par 3 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ nr MD-Nr 09/2014 për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbauesve Privat, por i njëjti ka theksuar që nuk do të bëjë plotësimin e ankesës sepse “dikush më ka thënë nuk ka kurrëgjë prej asaj pune” dhe nuk ka bërë plotësimin e ankesës sipas udhëzime.

Me datën 04.10.2021, Ministria e Drejtësisë -Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, ka paraqitur në Komision propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbauesit privat [REDAKTUAR], si organ përmbaues, i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në [REDAKTUAR], lidhur me ndërmarrjen e veprimeve përmbaimore përkatësisht mos marrjen e veprimeve përmbaimore.

Përmbauesi privat [REDAKTUAR] ka deklaruar se urdhri për përmbarim P. nr 544/21 është lëshuar me dt 30.06.2021, në bazë të dokumentit përmbarimor-Aktgjykimit. Me dt 02.08.2021, organi përmbarimor ka bërë bllokimin e llogarive bankare të palës debitore por nga Bankat kanë marrë njoftimin për mungesën e mjeteve. Po ashtu, është bërë ndalesa për regjistrim dhe shitje të automjetit. Përmbauesi privat thekson që me dt 04.08.2021, është bërë kërkesë për pasuri të paluajtshme në Agjensionin Kadastral të Kosovës, dhe nga i njëjti kanë marrë njoftim se pala debitore nuk ka të regjistruar pronë në emër të tij. Rrjedhimisht, përmbauesi privat thekson se ka vepruar sipas ligjit.

Me datën 02.11.2021, Komisioni ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, pala ankuese [REDAKTUAR] dhe përmbauesit privat, [REDAKTUAR]

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë-Departamenti për Profesione të Lira-Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj, Burbuqe Spahija, ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbauesit privat duke theksuar se mbetet pranë propozimit. Po ashtu pala ankuese ka ngeluar pranë ankesës së paraqitur me shkrim si dhe ka bërë elaborimin e saj. Përmbauesi privat gjithashtu ka paraqitur qëndrimin e tij lidhur me pretendimet e ngritura.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përmbauesi privat [REDAKTUAR] nuk ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni gjen me rëndësi të thekson se në rastin konkret ankesa, në thelb, konsiston në pretendimin se përmbauesi privat [REDAKTUAR] i nuk ka ndërmarrë veprimet ligjore për përmbarim. Pas shqyrtimit të shkesave të lëndës, Komisioni gjen se, megjithatë, pretendimi që përmbauesi privat nuk ka ndërmarr veprime ligjore në drejtim të përmbaimit është i paqëndrueshëm. Nga shkresat e lëndës është evidente që urdhri përmbarimor është lëshuar me dt 30.06.2021, në bazë të dokumentit përmbarimor-Aktgjykimit. Me dt 02.08.2021, organi përmbarimor ka bërë bllokimin e llogarive bankare të palës debitore. Po ashtu, përmbauesi privat ka ndërmarr veprime ligjore duke lëshuar ndalesa për regjistrim dhe shitje të automjetit. Tutje, përmbauesi privat me dt 04.08.2021, kishte kërkuar informacione për pasuri të paluajtshme në

Agjensionin Kadastral të Kosovës në emër të palës debitore. Fakti se përmbarimi nuk ka mundur të realizohet për shkak se pala debitore nuk ka mjete në llogaritë bankare dhe as pronë në emër të tij që do të mundësonin përmbarimin, nuk mund t'i atribuohen përmbaruesit privat si lëshime. Përmbaruesi privat ka ndërmarr gjitha veprimet ligjore brenda afateve pa vonesa të paarsyeshme. Rrjedhimisht, Komisioni vjen në përfundim se përmbaruesi privat ka vepruar në pajtim me ligjin dhe autorizimet ligjore.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL.nr 30/2021, datë 02.11.2021

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI



KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

1. The first part of the document is a list of names and addresses of the members of the committee.

2. The second part is a list of the names of the members of the committee.

3. The third part is a list of the names of the members of the committee.